


ÇFARË, PËRSE dhe SI:

NJË ANALIZË E RIVENDOSJES

RIVENDOSJA

Për ta dhënë mësim ungjillin, do t'ju nevojitet të jeni në gjendje të shpjegoni se çfarë janë braktisja, periudhat ungjillore dhe Rivendosja. Kjo tabelë mund të ndihmojë.

Një rivendosje është veprimi i kthimit të diçkaje në gjendjen e saj fillestare [restaurim]. Nuk është një reformim, i cili ndryshon diçka ekzistuese për të krijuar diçka të re. Për shembull, nëse dëshironit ta restauronit një shtëpi të vjetër, ju do ta ndërtonit atë sërish me të njëjtën planimetri që kishte ajo fillimisht. Ju mund të donit të shtonit një vatër të re zjarri, por atëherë do ta ndryshonit shtëpinë, nuk do ta restauronit.



Ungjilli i Jezu Krishtit nevojitet të rivendosej ngaqë kishte humbur gjatë Braktisjes së Madhe. Njerëzit kishin jetuar për shekuj pa Kishën e vërtetë. Prandaj Zoti i rivendosi Kishën dhe ungjillin e Tij nëpërmjet Jozef Smithit, pikërisht siç kishin profetizuar profetët e lashtë (shih Isaia 2:1-3; 29:13-14; Veprat e Apostujve 3:19-21; Zbulesa 14:6-7; 2 Nefi 3:3-15).

Ungjilli i vërtetë i Jezu Krishtit është këtu për të qëndruar – prandaj a do të qëndroni me të? Edhe pse bota bëhet gjithnjë e më e ligë, Kisha e Jezu Krishtit do të mbetet deri në fund.

Juve ju duhet të bëni një zgjedhje – të njëjtën zgjedhje që ka qëndruar përballë njerëzve [gjatë jetës] në vdekshmëri që nga fillimi i kohës: a do ta ndiqni profetin? Nëse e ndiqni, ju do të bekoheni dhe do ta keni Shpirtin për t'ju udhërrëfyer.

PERIUDHA UNGJILLORE

Profetët udhëheqin ato që quhen *periudha ungjillore*, periudha kohore kur: 1) Perëndia ka të paktën një udhëheqës të autorizuar të priftërisë në tokë dhe 2) ky udhëheqës, një profet, mëson rreth planit të shpëtimit drejtpërsëdrejti nga Perëndia. Profeti më pas ua mëson, ose *jep*, ungjillin njerëzve.

Falë shkrimeve të shenjta, ne kemi njohuri për shumë prej periudhave ungjillore. Disa periudha të rëndësishme ungjillore ishin ato të Adamit, Enokut, Noeut, Abrahamit, Moisiut, Jezu Krishtit dhe Jozef Smithit. Zoti filloi një periudhë ungjillore nëpërmjet secilit prej këtyre profetëve.



ILUSTRIME NGA BEN SIMONSEN

MËNYRA SE SI NDODH BRAKTISJA



BRAKTISJA

Braktisja=ligësi. Kur një individ ose grup largohet prej të vërtetave të ungjillit të Jezu Krishtit, i mohon profetët dhe bie në mëkat, ai është në braktisje.

Nga Feith Sathërlin Blekhërst

Revistat e Kishës

Le të themi se jeni në një udhëtim njëjavor në plazh me familjen e shokut apo shoqes suaj. Keni pasur shumë argëtim, por po fillon t'ju marrë malli për familjen tuaj. Pastaj babai ju dërgon një mesazh me celular që të shohë se si po shkojnë gjërat – ishte pikërisht çfarë ju nevojitet që ta ndienit se ju duan e ju kujtojnë.

Jeta në tokë është disi e tillë. Perëndia nuk na dërgon mesazhe me celular, por ne jemi larg prej shtëpisë sonë qiellore, prandaj një mënyrë se si Ati Qiellor na e komunikon dashurinë e Tij për ne, është duke dërguar profetë.